

RUAJTJA E TRADITAVE KULTURORE TEK GRUPET BILINGUALE – RASTI I EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË GJERMANI

Prof. asoc. Dr. JONIDA BUSHI (GJUZI)

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

jonida.bushi@unitir.edu.al

Prof.asoc. Dr. EMA KRISTO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

ema.kristo@unitir.edu.al

ABSTRACT

Learning a second or even third language does not consist only of learning a foreign vocabulary or communicating with a group that does not speak your language. Bilingualism or multilingualism is today the most efficient way to connect the new generation in whatever society this generation lives and integrates. The preservation and cultivation of identity is realized through language and culture. Many families leave their country and create a new life in another country. Their children grow up between two different cultures, that of the “parents’ home culture” and that of the new country. Most children grow up with two languages. Our interest in this article is in the study of how knowledge of culture facilitates the process of learning and teaching a language. How and to what extent are cultural traditions preserved in bilingual groups? We will specifically focus on the case of children of Albanian immigrants in Germany. How are the Albanian language and traditions preserved in these groups? In Europe in particular, the topic of integration and emigration of people from third countries and the intercultural education that is inevitably related to them is increasingly being discussed. Multiculturalism is creating an exchange between different cultures and thus strengthening the coexistence of a society. Intercultural education and the promotion of bilingualism are playing an increasingly important

role. Intercultural education goes beyond the promotion of bilingualism and is also related to the transmission of values, customs, traditions and religion.

Keywords: Bilingualism, multilingualism, intercultural education, culture, learning and teaching a language

Mësimi i një gjuhe të dytë apo edhe të tretë, nuk konsiston vetëm në të mësuarit e një fjalori të huaj apo komunikimin me një grup që nuk flet gjuhën tënde. Bilinguizmi apo multilinguizmi është sot mënyra më efikase për përgatitjen e brezit të ri në çfarëdo shoqërie që ky brez jeton dhe integrohet. Ruajtja dhe kultivimi i identitetit bëhet, përveç gjuhës, edhe përmes kulturës. Shumë familje largohen nga vendi i tyre dhe krijojnë një jetë të re në një vend tjetër. Fëmijët e tyre rriten mes dy kulturave të ndryshme, asaj të “kulturës së shtëpisë së prindërve” dhe asaj të vendit të ri. Shumica e këtyre fëmijëve rriten me dy gjuhë. Interesi ynë në këtë artikull qëndron në hulumtimin se si njohja e kulturës lehtëson procesin e nxënies dhe mësimin të një gjuhe. Si dhe sa ruhen traditat kulturore në grupet bilinguale? Do të fokusohemi konkretisht tek rasti i fëmijëve të emigrantëve shqiptarë në Gjermani. Si ruhen gjuha dhe traditat shqiptare në këto grupe?

Në Evropë në veçanti, tema e integritit dhe emigrimit të njerëzve nga vendet e treta dhe edukimi ndërkulturor që lidhet pashmangshmërisht me to po diskutohet gjithnjë më shumë. Multikulturalizmi po krijon një shkëmbim midis kulturave të ndryshme dhe në këtë mënyrë forcon bashkëjetesën e një shoqërie. Edukimi ndërkulturor dhe promovimi i dygjuhësisë po luajnë një rol gjithnjë e më rritje. Edukimi ndërkulturor shkon përtej promovimit të dygjuhësisë dhe lidhet gjithashtu me transmetimin e vlerave, zakoneve, traditave dhe fesë.

Në Gjermani jeton dhe punon gjenerata e dytë e emigrantëve shqiptarë të cilët kanë migruar apo kanë shkuar në vitet e 90-të si punëtorë.¹ Duke marrë për bazë se gjuha është mjet komunikimi

¹ Diaspora në Gjermani: Shqiptarët nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare emigruan në Gjermani pas vitit 1971, me heqjen e vizave dalëse nga ish Jugosllavia. Pas vitit 1990 drejt Gjermanisë migruan dhjetëra mijëra shqiptarë nga Shqipëria. Numri i emigrantëve shqiptarë në Gjermani ka ndryshuar me ritme të tjera nga ato të Italisë, Greqisë dhe ShBA-ve. Gjatë viteve 1990 – 1994 ky numër rritej me rreth 10 % në vit. Më pas norma vjetore e rritjes u zvogëlua në mënyrë konstante duke arritur në rreth 1 % përgjatë periudhës 2010 – 2014. Vetëm pas vitit 2015, numri i emigrantëve shqiptarë në Gjermani filloi të rritej me një normë vjetore prej rreth 35 %, duke e kthyer këtë vend si destinacionin kryesor të tyre. Kjo ka bërë që pesha që zënë emigrantët shqiptarë në Gjermani

dhe karakterizohet me përdorimin e simboleve arbitrare të folura ose të shkruara me një kuptim të caktuar, atëherë shtrohet pyetja si qëndron situata me gjuhën amtare shqipe te këta fëmijë të cilët janë lindur, rritur dhe shkolluar në Gjermani, me një kulturë dhe me një gjuhë tjetër të dytë? Çfarë nënkuptojmë me termin gjuhë amtare? Sa të sigurt dhe kompetent ndihen fëmijët e emigrantëve tanë jashtë vendit me theks të veçantë, ata që jetojnë dhe punojnë në Gjermani, gjatë përdorimit të gjuhës amtare shqipe dhe asaj gjermane?

Fëmijët e ardhur apo ata që lindin në Gjermani kanë të drejtën të mësojnë dhe flasin “gjuhën e tyre të nënës”. Në rastin e të ardhurve nga Shqipëria, fëmijët me prindër shqiptarë mund të mësojnë shqip, një mundësi kjo e krijuar ligjërisht nga disa lande përkatëse nëpër shkollat fillore dhe tetëvjeçare. Mësimi i gjuhës shqipe, i cili është jo i detyrueshëm, por thjesht një mësim mbi baza vullnetare, është i shtrirë pothuajse në të gjithë Gjermaninë. Shkollat e para të mësimi plotësues në gjuhën shqipe në Gjermani janë hapur në vitet 70 me ardhjen e emigrantëve të parë nga Ish Jugosllavija.²

Një rol të madh në drejtim të tërheqjes së fëmijëve me prejardhje shqiptare drejt mësimi të gjuhës amtare, ka luajtur *Këshilli i Arsimitarëve të Shqipes në Gjermani*. Ky organ profesional me përvojë tashmë gati 30 vjeçare ka si qëllim të bashkojë të gjithë mësuesit shqiptarë nga ana profesionale dhe të koordinojë bashkëpunimin me Institucionet përkatëse në Shqipëri dhe Kosovë. Në Mësimin e *Gjuhës së Prejardhjes*³ siç quhet sot, nxënësit mësojnë gjuhën, kulturën dhe traditat e vendit të origjinës. Programet mësimore janë të përcaktuara sipas kompetencave të mësimi të gjuhës amtare në bazë të standardeve evropiane. Mbi këtë koncept janë hartuar edhe kurrikulat e gjuhës shqipe, që janë të zbatuara në programet dhe tekstet mësimore. Krahës mësimi të gjuhës shqipe, mësuesit janë edhe aktivistë të jashtëzakonshëm në ruajtjen e traditës dhe kulturës kombëtare shqiptare, duke krijuar një urë lidhëse mes dy vendeve, Gjermani-Shqipëri. Në shumë aktivitete nuk mungojnë veshjet e bukura me kostumet kombëtare të vajzave valltare që shfaqen në çdo festë apo aktivitet kulturor. Përvetësimi i

në numrin gjithsej të emigrantëve të katërfishohet nga 1,3 % në 4,2 %. (<http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>) (f.17)

² <https://sot.com.al/opinione/migracioni-ne-gjermani-dhe-sfidat-e-femijeveshqiptar>

³ *Herkunftsspracheunterricht*

gjuhës amtare mbetet një nga sfidat më të mëdha për fëmijët shqiptarë, pasi ai është i rëndësishëm edhe për statusin social të individit. Njohja e gjuhës shqipe do të thotë jo vetëm njohja e vendit të origjinës, por edhe ruajtja e lidhjeve familjare, ruajtja e kulturës dhe traditave.

Kielhöfer/Jonekeit theksojnë se rrallëherë një person i flet të dyja gjuhët, pra gjuhën amtare dhe gjuhën e huaj (të vendit ku jeton) në mënyrë të barabartë. Në shumicën e rasteve ka një çekuilibrë midis dy gjuhëve. Prandaj, bëhet një dallim midis “gjuhës së fortë” dhe “të dobët”.⁴ Zhvillimi i *gjuhës së dobët* dhe *të fortë* varet nga shumë faktorë dhe karakterizohet nga një rrjet marrëdhëniesh shkak-pasojë. Faktorë të tillë përfshijnë mënyrën se si përdoret një gjuhë dhe intensiteti me të cilin përdoret ajo. Po aq e rëndësishme janë koha e mësimi dhe praktika e mëvonshme në atë gjuhë. Nuk duhen lënë pas dore gjithashtu arsyet emocionale, sociale dhe personale. Klasifikimi i gjuhës *së fortë* dhe *të dobët* bazohet në një model të thjeshtë shpjegues: në përgjithësi, gjuha e zotëruar më mirë është *gjuha e fortë*. Prandaj, kjo gjuhë preferohet dhe për këtë arsye flitet më shpesh. Anasjelltas, *gjuha e dobët* përdoret më rrallë, kështu që praktikohet më pak.⁵ Por në fakt, dallimi midis *gjuhës së fortë* dhe *të dobët* është i paqartë. Sepse personi dygjuhësh rrallë ka një zgjedhje të lirë të gjuhës. Faktorët specifikë të situatës shpesh përcaktojnë zgjedhjen e gjuhës, të tilla si takimi me miqtë e vjetër të shkollës ose aftësia për të komunikuar shpejt në një situatë të caktuar. Një çështje që nuk duhet neglizhuar është kuadri kulturor në të cilin rriten fëmijët dygjuhësh. Ndërgjegjësimi për gjuhën përkatëse krijohet vetëm nëpërmjet përkatësisë kulturore. Më pas varet nga forca e rrënjëve kulturore nëse kjo gjuhë do t’u kalohet brezave të mëpasshëm apo do të shmanget.⁶ Në rastin e njerëzve dygjuhësh, mund të bëhet një klasifikim sipas përkatësisë kulturore dhe identitetit të tyre. Mund të thuhet se personat dygjuhësh, që identifikohen me të dy grupet kulturore dhe gjuhën e tyre, pranohen gjithashtu si anëtarë të plotë në të dy grupet. Në këto raste, të dyja gjuhët zakonisht zotërohen njësoj mirë. Në dygjuhësinë monokulturore, të dyja gjuhët fliten mirë, por identiteti shfaqet vetëm me një grup kulturor. Grupi i përkatësisë jokulturore vërehet më së shumti te fëmijët e emigrantëve.

⁴ Kielhöfer/Jonekeit 1998: 11f

⁵ Kielhöfer/Jonekeit 1998: 12f

⁶ krh. Luchtenberg 1995: 61f

Grupi i përzgjedhur (kampioni)

Grupi i përzgjedhur për këtë punim përbëhet nga persona të cilët janë bilingualë në gjuhët shqip dhe gjermanisht. Janë përjashtuar nga ky grup personat të cilët nuk kanë prejardhje shqiptare edhe pse mund ta kenë mësuar gjuhën nëpërmjet kontakteve me shqiptarët si dhe personat që nuk janë shqiptarë, megjithëse mund të jenë martuar me shqiptarë. Pra kampioni apo grupi i përzgjedhur përbëhet nga popullsia e thjeshtë shqiptare.

Metodologjia e përdorur në studim është gërshtimi i metodologjisë sasiore dhe cilësore. Kampionimi i përdorur është një ndërthurje e kampionimit të qëllimshëm dhe atij në formë orteku. Personat bilingual të këtij studimi kanë referuar persona të tjerëpobilingual. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur si instrument pyetësorët e strukturuar dhe intervistat gjysmë të strukturuar.

Metodat e përdorura për mbledhjen e të dhënave

Bazën kryesore për të mbledhur të dhëna e përbëjnë intervistat. Ato ndahen në: *intervista në grup* dhe *intervista individuale*. Intervistat në grup kishin si qëllim të konstatonin ruajtjen e kulturës, traditave, dokeve dhe zakoneve shqiptare. Instrumenti më thelbësor në këtë punim është intervistat individuale e organizuar me bazë pyetësorin. Pyetjet e pyetësorit janë të standartizuara dhe kjo lehtësoi që shumë përfundime të paraqiten në formë tabelare. Takimet me shqiptarët bilingualë na u mundësuan nëpërmjet kontakteve të shumta personale. Intervistat në grup u organizuan jo vetëm në shtëpitë e shqiptarëve të atjeshëm, por edhe në vende publike si kafene apo në ndonjë shoqatë shqiptare. Me anë të intervistave në grup morëm informacione të hollësishme mbi organizimin social dhe aktivitetet kulturore të popullsisë shqiptare së atjeshme. Intervistat individuale morën më shumë kohë dhe përbëjnë edhe bazën e këtij punimi. Vizitat janë bërë në lande të ndryshme të Gjermanisë dhe puna në terren ka zgjatur rreth një muaj.

Intervistat

Në anketim morën pjesë 80 persona bilingual nga qyteti i Mynihut në landin e Bavarisë, Hamburgut, Dyseldorfit dhe Berlinit, të cilët i përkasin grupmoshës 14-19 vjeç. Të gjithë të intervistuarit flasin shqip dhe gjermanisht. Pyetësorët përbëhen nga dy pjesë. Të intervistuarve iu dha mundësia të bënin intervistën në gjermanisht ose në shqip. Në pjesën e parë të intervistave qëllimi ishte të identifikohet sfondi dygjuhësor i të intervistuarve dhe në pjesën e dytë u shtruan pyetjet që kanë të bëjnë me identitetin kulturor të tyre.


Në lidhje me përdorimin e gjuhës u formuluan tre hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza 1: Të rinjtë mendojnë shpesh në gjuhën shqipe kur komunikojnë me të rinj të tjerë shqiptarë ose me prindërit e tyre.


Hipoteza 2: Të rinjtë flasin gjermanisht shumë më shpesh kur komunikojnë me të rinj gjermane apo në shkollë.

Hipoteza 3: Të rinjtë preferojnë shumë më shpesh gjuhën gjermane kur diskutojnë tema të rëndësishme për adoleshencën e tyre.


Pyetja 1: Në cilën gjuhë mendoni?




Pyetja 2: Kur flisni me prindërit tuaj, mendoni në gjermanisht apo në shqip?




Pyetja 3: Kur flisni me vëllezërit e motrat ose me të rinjtë që flasin shqip mendoni në gjermanisht apo në shqip?




Pyetja 4: Në cilën gjuhë ëndërroni?



Pyetja 5: A është e rëndësishme njohja e mirë e gjuhës shqipe për të ardhmen tuaj?




Pyetja 6: Kur flisni me të rinj gjermanë, mendoni në gjermanisht apo në shqip?




SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”


Pyetja 7: Kur flisni me mësuesit, mendoni në gjermanisht apo në shqip?




Pyetja 8. Dy gjuhë, dy kultura - a është ky problem për ju?




Pyetja 9: Sa mirë mund të shkruani në shqip?




Pyetja 10. Sa mirë mund t'i lexoni dhe kuptoni tekstet shqipe?




Pyetja 11: Në cilën gjuhë shani apo qortoni?




Pyetja 12: Në cilën gjuhë luteni?



Pyetje 13: Sa ju pëlqen të flisni shqip?




Pyetja 14. A është e rëndësishme njohja e mirë e gjuhës shqipe për të ardhmen tuaj?




SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET
DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”


Pyetja 15. Në cilën gjuhë ndiheni më të sigurt?




Pyetja 16. Sa drejt flisni shqip? (Gramatika, fjalori, zhargon)



Pyetja 17. Sa saktë flisni gjermanisht? (Gramatika, fjalori, gjuha e folur, gjermanishtja standarde)



Pyetja 18. Sa mirë mund të shkruani në shqip?



Përmbajtja e përgjigjeve të pyetjeve të mësipërme paraqitet si më poshtë:

Në lidhje me pyetjet që kanë të bëjnë me “besimin gjuhësor”, të rinjtë deklarojnë dukshëm se ndihen më të sigurt në gjuhën gjermane.

Në lidhje me pyetjet që kanë të bëjnë me saktësinë gjuhësore të intervistuarit arritën në një vetëvlerësim mesatarisht më të mirë të aftësive të tyre të folurit në të katër nënfushat (gramatika, fjalori, gjuha bisedore, gjermanishtja standarde) në gjuhën gjermane.

Në lidhje me grupin e pyetjeve “Cilësia e të shkruarit në shqip” dhe “Cilësia e leximit dhe të kuptuarit në gjermanisht”, mesatarisht të intervistuarit dhanë një vetëvlerësim më të mirë për njohuritë në gjuhën gjermane.

Përvetësimi i njohurive si në gjuhën gjermane ashtu edhe në atë shqipe zhvillohet tek fëmijët apo të rinjtë nëpërmjet ndërveprimeve, pra në formën e shkëmbimit të akteve gjuhësore nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të dy gjuhëve shqip dhe gjermanisht. Fëmijët/Të rinjtë bilingualë e kanë të vështirë të mësojnë gjuhën shqipe, sepse mundësitë jashtëshkollore për kontaktin me gjuhën shqipe për ta vështirë se ekzistojnë dhe për rrjedhojë përdorimi i gjuhës amtare është jashtëzakonisht i vogël. Pavarësisht mundësive të pakta, interesi dhe dëshira e fëmijëve të flasin gjuhën amtare dhe të ndjekin *Mësimin Plotësues të Gjuhës Shqipe* është i madh. Qëllimi është që fëmijët shqiptarë në Gjermani të lexojnë dhe shkruajnë një gjuhë të standarteve dhe nivele të larta, që jo vetëm ta kuptojnë, por edhe ta flasin bukur dhe rrjedhshëm gjuhën e nënës.


Rezultatet e pyetësorëve treguan se shumica e personave bilingualë kanë një gjuhë ‘të fortë’ dhe ‘të dobët’. Ky dominim gjuhësor mund të zhvendoset gjatë rrjedhës së jetës. Nëse, për shembull, shqipja është përvetësuar si gjuhë e origjinës në familje, kjo gjuhë është mbizotëruese në fëmijërinë e hershme. Sa më gjatë që fëmija të shkojë në shkollë, aq më shumë rritet ndikimi i gjermanishtes, pasi fëmija ndeshet me gjuhën gjermane në çdo hap, jo vetëm në shkollë, por edhe në jetën e përditshme. Fëmijët dhe të rinjtë dygjuhësh demonstrojnë një nivel të lartë të aftësisë së gjuhës së folur në gjuhën e tyre amtare, por shpesh shfaqin dobësi në të shkruar. E rëndësishme është që familjet emigrante të vazhdojnë të përdorin gjuhën shqipe në shtëpi si gjuhë

familjare, sepse familja është shpesh i vetmi kontakt i qëndrueshëm me gjuhën e origjinës.


Mësimet në gjuhën amtare janë gjithashtu shumë të dobishme. Fëmijët shkollohen në gjuhën e tyre amtare, mësojnë të shkruajnë e të lexojnë dhe ta përdorin gjuhën në një kontekst më të gjerë jashtë familjes. Njerëzit që rriten duke folur dy ose më shumë gjuhë, mund të kuptojnë më lehtë në kultura të ndryshme, të vlerësojnë gjuhët dhe traditat e tjera dhe kështu të kontribuojnë në një shoqëri kozmopolite. Nëse të dyja gjuhët promovohen në përputhje me rrethanat, ka perspektiva më të gjera profesionale dhe kapital më të madh kulturor.

Pjesa e dytë e intervistave ka të bëjë me ruajtjen e dukurive tradicionale shqiptare, me kodet e të qenit shqiptar. Pyetjet janë të hapura dhe qëllimi është të tregohet se çfarë lidhjesh kulturore kanë mbajtur familjet emigrante me vendin e tyre. Disa prej pyetjeve në këtë pjesë:


Pyetje 1. Cilat tradita shqiptare njihni?




Pyetje 2. Cilat festa popullore shqiptare festoni?




Pyetje 3. A njihni valle dhe këngë popullore shqiptare?




Pyetje 4. Nëse po, cilat?



Pyetje 5. A lexoni përralla shqiptare?




Pyetje 6. A i njihni ritet fetare shqiptare?




SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË KULTURORE TË FLASË? – KREATIVITET
DHE NDËRMJETËSIM NË NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”


Pyetje 7. Kur dëgjoni muzikë, më së shumti dëgjoni muzikë nga vende të ndryshme apo muzikë shqiptare?




Pyetje 8. A ju edukuan prindërit sipas traditave shqiptare?



Pyetje 9. Cilat veshje tradicionale shqiptare njihni?



Pyetje 10. Cilat objekte tradicionale shqiptare njihni?



Gjatë intervistave në grup u konstatua se *festat, ritet dhe veprimtaritë kulturore janë* tregues i rëndësishëm i ruajtjes së identitetit. Nga shqiptarët në qytete të ndryshme të Gjermanisë festohen festa të shumta si festat e nëntorit, festa e ditës së verës etj. Dasmat dhe vdekjet bëhen sipas traditës shqiptare, aty ku komunitetet shqiptare janë më të mëdha.

Shoqata të shumta kulturore, të krijuara në Gjermani kanë emërtime shqiptare. Këto shoqëri kulturore, zhvillojnë aktivitete të shumta, të cilat shpesh i zhvillojnë në bashkëpunim me njëra tjetrën, si në Europë, Amerikë apo në vendet e Lindjes. Është vërejtur se në disa familje mbahet simboli i shqiponjës, përkrenarja e Skënderbeut, punime artistike të kalave shqiptare (Krujë, Berat, Gjirokastër etj), si dhe shumë simbole të hershme, figura të mitologjisë shqiptare, që zbukurojnë veglat muzikore popullore. Të tilla elemente kulturore flasin për lidhje me atdheun, psikologjinë dhe traditën e të parëve tanë. Jo në pak familje janë edhe simbole fetare, sipas përkatësisë. Një pjesë e këtyre simboleve janë punuar nga vetë emigrantët, por edhe janë marrë nga vendi i origjinës së tyre, në raste festash, përkujtimeve, apo vizitave në vendin e origjinës.

Traditat nëpërmjet shkollimit dhe takimeve – Emigrantët e rinj kanë shqetësimin e mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës sonë kombëtare. Siç e përmendëm në fillim të artikullit, në Gjermani po funksionojnë shumë shkolla për mësimin e gjuhës shqipe. Orët e mësimin me fëmijët e shqiptarëve janë vërtetë shumë interesante. Sipas të dhënave nga të

intervistuarit, fëmijët interesohen për çdo gjë që lidhet me atdheun. Përveç orëve të mësimit të gjuhës, mësuesit u tregojnë fëmijëve për bukuritë e atdheut. Ata u tregojnë atyre legjenda e tregime të bukura, të cilat ata vetë i kanë mësuar në atdhe ose në familjet e tyre. Është si një lloj stafete që gjeneratat e shqiptarëve në Gjermani ia pasojnë njëri-tjetrit. Objektet e marra me vete, shumë nga emigrantët i ruajnë si të shenjta. Fëmijët e tyre, sipas bisedave me emigrantët, donin të dinin si është ndërtuar furka e gjyshes, qebapi i kafes etj, objekte të marra me vete nga vendlindja.

Në vendet ku janë, shqiptarët kanë dëshmuar si komunitet që aspiron dhe punon për t'u integruar në shoqërinë pritëse, dhe që ruan vlera të mëdha nga origjina e tyre. Dukuritë tradicionale shqiptare, festat, tregimet dhe legjendat nga viset tona, psikologjia e ndihmës, e shoqërimit etj, janë kode të të qenit shqiptar. Shkollimi i fëmijëve në Perëndim, duke përdorur edhe gjuhën shqipe, është shenjë e mirë për ruajtjen e identitetit.

Përfundime

Ky artikull pasqyron lidhjen midis identitetit dhe gjuhës në rastin e shumëgjuhësisë së lidhur me emigracionin si pjesë e një studimi empirik. Rezultatet e hulumtimit tregojnë qartë se ekziston një lidhje e ngushtë midis gjuhës dhe identitetit dhe se të dyja ndikojnë njëra-tjetrën. Nga kjo rrjedh supozimi se çdo gjuhë e sapomësuar kontribuon në identitetin e një individi dhe bën që identiteti gjuhësor i emigrantëve të përjetohet si kompleks dhe i koduar shumëfish. Dygjuhësia dhe shumëgjuhësia e personave do të thotë që ata ndiejnë se i përkasin disa botëve gjuhësore dhe kulturore dhe pak a shumë identifikohen me të gjitha. Ata e bashkojnë këtë diversitet brenda vetes dhe për këtë arsye shfaqen si individë urë që kanë arritur të formojnë një identitet hibrid, multikulturor. Identiteti i tyre multikulturor shprehet, ndër të tjera, me ndryshimin e gjuhëve, gjë që shënon pozicionin e tyre në raport me bashkëbiseduesit e ndryshëm dhe përkatësinë e tyre në grupe të ndryshme.

Të rinjtë fitojnë njohuri si të gjermanishtes ashtu edhe të shqipes me anë të ndërveprimeve, pra në formën e një shkëmbimi procesor të veprimeve gjuhësore nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të dy gjuhëve shqip dhe gjermanisht.

U paraqitën tre hipoteza në lidhje me aspektin gjuhësor:

Hipoteza 1: Të rinjtë mendojnë shpesh në gjuhën shqipe kur komunikojnë me të rinj të tjerë shqiptarë ose me prindërit e tyre.

Hipoteza 2: Të rinjtë flasin gjermanisht shumë më shpesh kur komunikojnë me të rinj gjermane apo në shkollë.

Hipoteza 3: Të rinjtë preferojnë shumë më shpesh gjuhën gjermane kur diskutojnë tema të rëndësishme për adoleshencën e tyre.

Këto tre hipoteza u vërtetuan bazuar në përgjigjet e dhëna nga të intervistuarit.

Meqenëse të rinjtë sasinë më të madhe të kohës e kalojnë në një ambient gjermanishtfolës, ata kanë më shumë mundësi për trajnim dhe zgjerim gjuhësor në gjuhën gjermane se sa në gjuhën shqipe. Si rrjedhim ata kanë më shumë siguri në gjuhën gjermane. Gjuhën shqipe ata e përdorin më shumë jashtë shkollës, në familje dhe në komunikim me bashkëmoshatarë ose të rriturit shqiptarë.

Përsa i përket ruajtjes së identiteti kulturor gjatë intervistave u konstatua se festat, ritet dhe veprimtaritë kulturore janë tregues i rëndësishëm i ruajtjes së identitetit shqiptar. Nga shqiptarët në Gjermani festohen festa të shumta shqiptare, njihen objekte dhe veshje tradicionale si dhe rite të caktuara fetare.

BIBLIOGRAFIA

- KIELHÖFER, BERND/JONEKEIT, SYLVIE (1998): Zweisprachige Kindererziehung, 10. Auflage, Verlag Stauffenburg, Tübingen.
- LUCHTENBERG, SIGRID (1995): Interkulturelle sprachliche Bildung. Zur Bedeutung von Zwei- und Mehrsprachigkeit für Schule und Unterricht. Münster u.a.: Waxmann.
- NIEKE, WOLFGANG (1991): Situation ausländischer Kinder und Jugendlicher in der Bundesrepublik Deutschland: Vorschule, Schule, Berufsausbildung, Freizeit und Kriminalität. In: Lajios, K. (Hrsg.): Die zweite und dritte Ausländergeneration. Ihre Situation und Zukunft in der Bundesrepublik Deutschland. Opladen: Leske+Budrich.

SITOGRAFIA:

- <https://sot.com.al/opinione/migracioni-ne-gjermani-dhe-sfidat-e-femijeveshqiptar>
- <http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>